

## Zbatimi i masave mbrojtëse për pacientët dhe shoqëruesit e tyre

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet në mbledhjen e tij zhvilluar në datë 29.9.2020 dhe protokolluar me Nr.490/14, datë 15.10.2020, propozoi publikimin e këtij materiali me qëllim ndërgjegjësimin e mjekëve imazheristë/radiologë për masat mbrojtëse që duhet të zbatohen gjatë një egzaminimi radiologjik për pacientët dhe shoqëruesit e tyre.

Egzaminimet radiologjike duhet të jenë të justifikuara dhe optimizuara nga mjeku imazherist/radiolog. Gjatë një egzaminimi radiologjik ata duhet të marrin në konsideratë zbatimin e masave mbrojtëse, si për pacientët, ashtu dhe për familjarët që janë të detyruar të shoqërojnë pacientët. Për pacientët duhet të përdoren masa mbrojtëse për gonadet, ndërsa për familjarët që i shoqërojnë gjatë një egzaminimi duhet të përdoren përparëse plumbi.